



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 1530 Prot.

Tiranë, më 07.06.2024

NJOFTIM PËR MBARËVAJTJEN E FUSHATËS ZGJEDHORE NË UST

TRUPËS ZGJEDHORE TË PERSONELIT AKADEMIK TË UST

TRUPËS ZGJEDHORE TË STUDENTËVE TË UST.

**KANDIDATËVE PËR ZGJEDHJEN NË ORGANET DHE
AUTORITETET DREJTUESE TË UST.**

Komisioni Institucional Zgjedhor i UST, në ushtrim të detyrave, funksioneve dhe kompetencave që i përcaktohen në Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në UST”, miratuar me vendimin nr. 32, datë 22.04.2024 të Senatit Akademik të UST;

- Duke marrë shkas nga kërkesa dhe ankesa të kandidatëve të administruara në KIZ;
- Duke konstatuar komunikime elektronike, të trajtës së urdhrit, të drejtuara personelit akademik dhe me objekt procesin zgjedhor;
- Me qëllim mbështetjen dhe mbarvajtjen e çdo faze të procesit zgjedhor që po zhvillohet në UST;

Sjell në vëmendje të të gjithë anëtarëve të personelit akademik, studentëve dhe kandidatëve për zgjedhje në organet dhe autoritetet drejtuese të UST, sa vijon:

1. Komisioni Institucional Zgjedhor, sipas rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në UST”, është **Institucioni përgjegjës për përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve!**
2. Komisioni Institucional Zgjedhor, mbështetur në nenin 6, pika 2, germa a), ushtron kompetencën e: **“Nxjerrjes së udhëzimeve për organizimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor në të gjitha njësitë e UST-së”!**

3. Komisioni Institucional Zgjedhor, mbështetur në nenin 6, pika 2, germa b), ushtron kompetencën e: **“Drejton dhe kontrollojnë të gjithë procesin zgjedhor”!**
4. Mbështetur në nenin 38, pika 8, rregullorja “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në UST”; **“është e detyrueshme për t`u zbatuar si e tillë nga i gjithë personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ i Universitetit të Sporteve”!**

Në këtë kontekst, asnjë strukturë akademike e UST dhe asnjë autoritet drejtues, nuk ka të drejtën e ndërhyrjes në asnjë lloj forme në proceset që lidhen me organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në UST.

Komisioni Institucional Zgjedhor, udhëzon dhe inkurajon të gjithë personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhohen dhe të mbështesin zhvillimin e fushatës zgjedhore të kandidatëve të gjithë niveleve sa më gjithëpërfshirëse, të barabartë dhe në përputhje me vlerat, parimet dhe detyrimet që përcakton rregullorja e zgjedhjeve.

Komisioni Institucional Zgjedhor, siguron personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrative, studentët dhe kandidatët për bashkëpunimin dhe komunikimin e vazhdueshëm në funksion të realizimit sa më efektiv të zgjedhjeve.

Ky Njoftim të publikohet në ambiantet e Universitetit të Sporteve të Tiranës.

ERISA ALIAJ

ANËTAR

HOLTJON ORHANI

ANËTAR

OREST SHYTAJ

ANËTAR

ARMANDO CUNGU

ANËTAR

INDRIT REKA

KRYETAR

